

VENDIM
Nr. 10/2024

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 55/2014,
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT
E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 16, pika 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 55/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.1.2024.

ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT DEKLARIMIT E
KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/klasa
I. Inspektori i Përgjithshëm	1	Ligji nr.34/2023, datë 25.5.2023
II. Kabineti		
Drejtor Kabineti	1	I-3
Këshilltar	1	I-4
Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm	1	VKM nr. 325, datë 31.5.2023
III. Sekretari i Përgjithshëm	1	I-2
IV. Inspektor		
Inspektor	28	I-4
Ndihmës Inspektor	12	II-1
V. Drejtorja Juridike dhe e Marrëdhënieve me Institucionet		
Drejtor	1	II-1
V/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet		
Përgjegjës sektori	1	III-1
Specialistë	3	IV-1
V/2. Sektori i Këshillimit Juridik		
Specialist	2	IV-1
VI. Drejtorja e Informacionit dhe Teknologjisë		
Drejtor	1	II-1
VI/1. Sektori i Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Infrastrukturës		
Përgjegjës	1	III-1
Specialist	3	IV-1
VII. Drejtorja e Financës dhe Administrimit		
Drejtor	1	II-1
VII/1. Sektori i Protokoll-Arkivit dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë		
Përgjegjës sektori	1	III-1
Specialist	5	IV-1
VII/2. Sektori i Administrimit të Financë-Buxhet		
Përgjegjës sektori	1	III-1
Specialist finance	1	IV-1
Specialist buxheti	1	IV-1
Magaznier	1	V
Shofer	2	III
Receptionist	1	II
Punonjës Pastrimi	2	I
Gjithsej	73 punonjës	